



UDHEZUES I REFERIMIT TE SHPEJTE PER DOREZIMIN E KERKESES TUAJ TE PAPUNESISE

www.filectui.com

Krijimi i një Llogarie në Internet

1). Shkoni tek faqja e sigurtë në internet e Departamentit të Punës www.filectui.com dhe zgjidhni këtë pjesë:



2). Zgjidhni një Identifikim dhe Fjalëkalim të Përdoruesit për të përdorur Shërbimet tona në Internet

E rëndësishme: Mund të hyni vetëm duke përdorur Identifikimin dhe Fjalëkalimin e Përdoruesit që zgjidhni. Gjithnjë sigurohuni se i gjithë informacioni është shkruar dhe ruajtur për referime në të ardhmen.

3). Krijoni një metodë të pagesës (metoda e pagesës mund të krijohet vetëm në internet):

- Klikoni “Butoni i Zgjedhjes/Ndryshimit të Pagesës”
- Zgjidhni opsionin Depozitë e Drejtpërdrejtë ose opsionin Karta e Debisë

*Vini re: Metoda e pagesës mund të ndryshohet ose modifikohet në çdo kohë

Këshilla për Depozitën e Drejtpërdrejtë - ofron pagesë më të shpejtë	Këshilla për Kartën e Debisë
Nëse zgjidhni Depozitën e Drejtpërdrejtë, futni si numrin kalimtar ashtu edhe atë të llogarisë tuaj duke ndjekur diagramën (kontrolloni me institucionin tuaj financiar për të verifikuar numrin e saktë kalimtar dhe të llogarisë)	Nëse nuk zgjidhet Depozita e Drejtpërdrejtë, një Kartë e Debisë do t’ju dërgohet automatikisht pasi pagesa juaj të jetë miratuar (do të duhen deri në 10 ditë pune brenda kështit të pagesës së parë për të marrë Kartën tuaj të Debisë nga Chase).
Vetëm një llogari bankare personale mund të përdoret për të krijuar Depozitën e Drejtpërdrejtë. Emri juaj duhet të jetë në llogarinë bankare.	Nëse Karta juaj e Debisë nga Chase ju ka humbur ose u është vjedhur, kontaktoni Chase Bank që t’ju jepet një kartë e re: 1-866-315-7808

4). Përdorni internetin për të dorëzuar kërkesën tuaj të vazhdueshme të përjavëshme:

- Klikoni butonin “Dorëzoni një Kërkesë të Vazhdueshme të Përjavëshme”.
- Lexoni dhe përgjigjuni me kujdes pyetjeve në lidhje me javën e mëparshme.
- Klikoni “Dorëzoni” dhe sigurohuni se keni dorëzuar me sukses kërkesën.

*Vini re: Duhet të dorëzoni një kërkesë të përjavëshme për secilën javë që jeni të papunë në mënyrë që të merrni përfitime.

Nëse nuk dorëzoni kërkesën tuaj të vazhdueshme të përjavëshme, nuk do të jeni në gjendje të vazhdoni të dorëzoni kërkesa. Në këtë rast, ju lutemi shkoni tek www.filectui.com ose kontaktoni linjën Përfitimet përmes telefonit dhe zgjidhni opsionin #1 për të zgjidhur këtë situatë.

5). Si të merrni informacionin e pyetjeve për kërkesën/të printoni historinë e kërkesave/të merrni informacionin për taksat mbi të ardhurat:

- Klikoni butonin “Bëni Pyetjet për Kërkesën”.
- Shikoni ose printoni informacionin e pagesës, ose shikoni ose printoni një kopje të informacionit të taksave mbi të ardhurat.

Shërbime Shtesë në Internet

Për të përdorur opsionin e **Ndihmës për Papunësinë** që gjendet në www.filectui.com, zgjidhni pjesën vjollcë që gjendet në pjesën e majtë të faqes. Kërkesat do të marrin përgjigje brenda 24 orësh dhe përfshijnë këto shërbime:



• Kërkesë për shkyçjen e llogarisë	• Raportimi i kthimit në punë
• Kërkesë për ndryshimin e adresës	• Rikonfigurimi i numrit tuaj personal të Përfitimeve përmes telefonit
• Ndryshimi i gjendjes së mbajtjes së taksave mbi të ardhurat	• Dërgimi i një e-mail me një pyetje
• Dorëzimi i një kërkesë të vazhdueshme për një javë që mungon	• Pyetja se pse nuk morët pagesat ose pse nuk jeni të autorizuar për të bërë kërkesë

Dorëzimi i Kërkesave të Vazhdueshme të Përvëshme

- 1). **Duhet të dorëzoni një kërkesë të vazhdueshme të përvëshme çdo javë.** Nëse nuk dorëzoni një kërkesë për një javë, nuk do të jeni në gjendje të vazhdoni të dorëzoni kërkesa. Kjo do të vonojë pagesën e përfitimeve tuaja meqëse duhet të kontaktoni agjencinë për të rihapur kërkesën tuaj.
 - **Dorëzimi i kërkesës së përvëshme në internet:** Kjo është mënyra më e thjeshtë dhe më e shpejtë për të bërë kërkesë. Shkoni tek www.filectui.com dhe klikoni lidhjen Dorëzoni një Kërkesë të Vazhdueshme për të hyrë tek llogaria juaj.
 - **Dorëzimi i një kërkesë të përvëshme me telefon:** Nëse nuk jeni në gjendje të bëni dorëzimin në internet, mund t'i telefononi linjës së Përfitimeve përmes telefonit dhe zgjidhni Opsionin 1. Numrat telefonikë për sistemin Përfitimet përmes telefonit janë renditur në pjesën e pasme të broshurës Të Drejtat e Përfitimeve ose duke telefonuar 2-1-1.
- 2). **Ndërsa shumica e njerëzve e dorëzojnë kërkesën e përvëshme të tyre të dielën për javën e mëparshme kalendarike, kërkesa juaj mund të dorëzohet gjatë secilës prej këtyre orëve:**
 - Orët e dorëzimit TE DIELEN: 12:01 paradite deri në 11 pasdite
 - Orët e dorëzimit E HENE – E PREMTE: 6 paradite deri në 8 pasdite

*Vini re: Nëse bëni një gabim kur i përgjigjeni ndonjë prej pyetjeve të dorëzimit, mund të futeni përsëri tek “Dorëzoni një Kërkesë të Vazhdueshme të Përvëshme” dhe përgjigjuni përsëri pyetjeve tuaja brenda të njëjtës ditë.
- 3). Duhet të raportoni të gjitha të ardhurat bruto të fituara për punë të kryer brenda javës së kërkesës. Të ardhurat bruto janë ato që keni fituar përpara sesa të llogariten taksat. Mosraportimi i punësimit kur kryhet punë do të rezultojë në një mbi-pagesë dhe mund të rezultojë në Dënim Administrativ që barazohet me 50 përqind të shumës së mbi-paguar.
- 4). Raportimi i të Ardhurave të Pjesshme: Nëse punuat me kohë të plotë ose të pjesshme për një punëdhënës, në vetë-punësim ose u kthyet në punë me kohë të plotë gjatë javës që përfundon të shtunën e fundit të kërkesës tuaj, mund të kualifikoheni për të dorëzuar një kërkesë të punësimit të pjesshëm.

Përdorni këto udhëzime kur bëni dorëzimin:

 - Nëse filloni të punoni me kohë të pjesshme gjatë çdo jave që jeni duke bërë kërkesë, duhet të raportoni të gjitha të ardhurat bruto (paga përpara sesa të zbriten taksat) për kohën që keni punuar – jo kur paguheni.
 - Të ardhurat bruto përfshijnë bakshishe, shpërblime, dieta dhe të ardhura për detyra të përherëshme/të përkohëshme.
 - Shumëzoni orët e punës me nivelin për orë. Për shembull: 10 orë x \$10 në orë = \$100. Shtoni të gjitha bakshishet tek kjo shumë.

*Vini re: Për më shumë informacion mbi dorëzimin e pagave të pjesshme, referojuni faqes 9 në broshurën tuaj Të Drejtat e Përfitimeve.

Udhëzime të Rëndësishme të Përfitimeve të Papunësisë

- Afati Kohor: Individët që kualifikohen mund të grumbullojnë 26 javë të përfitimeve në një vit të përfitimeve me 52 javë.
- Mungesa e Verifikimit të Punës: Kërkesa do të mbetet pezull për nëntë ditë për të verifikuar ndarjen nga punësimi.
- Seanca e Planifikuar: Kërkesa është pezull për deri në 10 ditë pas një seance.
 - Nëse miratoheni, do të merrni pagesat pezull prandaj duhet të dorëzoni kërkesat tuaja të përvëshme
 - Nëse refuzoheni, mund të bëni një ankim në internet duke gjetur “Dorëzimi i një Ankimi në Internet” nën “Lidhje tek Burime të Dobishme” që gjendet tek www.filectui.com



Ndihma për Ripunësim

Departamenti i Punës ofron shumë shërbime pa kosto të ripunësimi si kërkime për punë dhe ndihmë me rezyme, këshillim të karrierës, rekrutim të punëdhënësit dhe një bankë të vendeve të punës me vetë-shërbim në internet. Për më shumë informacion në lidhje me burime në dispozicion për ju shkoni tek www.CT.jobs ose shkoni tek Qendra Amerikane e Vendeve të Punës e juaj vendore. Për të gjetur një Qendër Amerikane e Vendeve të Punës të leverdishme, referojuni faqes 38 në broshurën tuaj të informimit mbi Të Drejtat e Përfitimeve.